



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) dhe (i) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 13 të Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë \_\_\_\_\_ 2025, të miratojë këtë:

**PROPOZIM**

## **V E N D I M**

### **PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE KONJUH**

#### **Neni 1**

1. Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat Komunale që gjinden në Zonën Kadastrale Konjuh të përshkruara si në vijim:

- 1.1. Njësia kadastrale P-71409036-00166-7 me sipërfaqe 12357 m<sup>2</sup> ZK Konjuh, Komuna Lipjan
- 1.2. Njësia kadastrale P-71409036-00164-20 me sipërfaqe 17643 m<sup>2</sup> ZK Konjuh, Komuna Lipjan.

#### **Neni 2**

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale jepen në shfrytëzim në periudhen afatgjatë prej 99 vitesh nëpërmjet Njoftimit publik dhe janë publikuar brenda afatit ligjor në ueb faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës së Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik Nr.01-463/02-63795 datë 27.12.2024 të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues 2025 konform dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

09

### **Neni 3**

Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi, është interesi publik, zhvillimit ekonomik, përfitimi ekonomik i komunës nga pronat komunale si dhe funksionalizimi i pronës komunale.

Dhënja në shfrytëzim e pronave të lartëcekura komunale, destinohet kryesisht për ndërtimin e ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore, në mënyrë që subjekteve të interesuara të i'u mundësohet të ofertojnë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit.

Sipas aktit Informacion për lokacionin datë 11.11.2024 Nr.8-351/01-55876 nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DPUMM-ja), parcelat komunale në ZK Konjuh, janë të destinuara si Zonë Komerciale përkatësisht Shërbim Tregtar Rural, bazuar në të dhënat nga Harta Zonale e Komunës të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.30033 datë 03.06.2021.

### **Neni 4**

Procedurën e Njoftimit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092 dhe Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

### **Neni 5**

Zgjedhja e ofertës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

### **Neni 6**

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.

### **Neni 8**

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.



## Arsy e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Rregullorja (QRK) Nr.09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Parcelat kadastrale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi janë të koncentruara në Zonën kadastrale Konjuh. Propozimi për dhënien në shfrytëzim të këtyre parcelave bëhet në mënyrë që subjekteve të interesuara të i'u mundësohet të ofertojnë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e vlerës së pronës komunale. Pronat komunale të lartëcekura janë publikuar brenda afatit ligjor në ueb faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës së Kryetarit-Sektorit Pronësoro-Juridik Nr.01-463/02-63795 datë 27.12.2024 të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues 2025 konform dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, andaj kërkojmë nga kuvendi komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

01-462/01-2676  
Lipjan, më 14.01 .2025

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





Data: 11.11.2024

Numri i vrojtimit: 8-351/01-55876

Në bazë të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të prezentuara, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lëshon këtë:

### INFORMACION PËR LOKACIONIN

Ky Informacion i lëshohet:			
Emri dhe mbiemri/Aplikuesi:	Lumnije Ejupi , Shefe e Sektorit Pronsoro-Juridik Komuna Lipjan		
Adresa:	Komuna Lipjan		
Telefoni:	-		
Për Lokacionin në vijim;			
Adresa:	Konjuh		
Zona kadastrale:	Konjuh	Parcelat kadastrale:	P-71409036-00166-7 P-71409036-00164-20 P-71409036-00164-23
<p>Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me kërkesën 8-351/01-55876 të datës 17.10.2024 prezentuar nga Lumnije Ejupi , Shefe e Sektorit Pronsoro-Juridik Komuna Lipjan, lidhur me informacionin për lokacionin për parcelat kadastrale: P-71409036-00166-7 me sipërfaqe 12357 m<sup>2</sup> e cila është në posedim të Psh. Kuvendi Komunal Lipjan, Shfrytëues SHPK BEN-AF me nr. Personal 70077761 e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale 1044-2024 dt 19.007.2024, parcela kadastrale P-71409036-00164-20 me sipërfaqe 17643 m<sup>2</sup>, e cila është në posedim të Psh. Kuvendi Komunal Lipjan, Shfrytëues SHPK BEN-AF me nr. Personal 70077761 e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale 1044-2024 dt 19.007.2024, parcela kadastrale P-71409036-00164-23 me sipërfaqe 15000 m<sup>2</sup> e cila është në posedim të Komunës së Lipjanit evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale 4715/2024-07.11.2024. Parcela Kadastrale në fjalë gjenden në Zonën Kadastrale Lipjan. Bazuar në të dhënat nga Harta Zonale e Komunës të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal 15Nr.30033 dt.03.06.2021, ju njoftojmë si vijon:</p> <p>Parcelat Kadastrale për të cilat lëshohet ky informacion për lokacionin janë me nr: P-71409036-00166-7, P-71409036-00164-20, P-71409036-00164-23 ZK Konjuh dhe është destinuar si <b>Zonë Komerciale</b> përkatësisht <b>Shërbim Tregtar Rural (shih hartën I)</b>.</p>			

- Bashkangjitur keni skicat grafike si dhe pjesën tekstuale nga Harta Zonale e Komunës për llojin e aktiviteteve të lejuara për këtë zonë.

Nga të dhënat më lartë DPUMM konstaton se ky Akt mund të shërbejë si informacion për gjendjen aktuale sipas Hartës Zonale të Komunës, ndërsa procedurat tjera rreth zhvillimit të aktiviteteve ndërtimore do të zhvillohen konform rregullativës ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit dhe dispozitave tjera ligjore që rregullojnë fushën e shfytëzimit dhe ndërtimeve.

**Bashkangjitur:**

Skica grafike si dhe pjesa tekstuale nga HZK.

Përpunoi:

Jetmir Bytyçi

Zyrtar Për Mbrojtjen e Mjedisit



Kontrolloi:

Jalldyze Kallaba

Zyrtare Për Leje Ndërtimore



Klari Semetishti

Drejtor DPUMM-së



Pranuar nga: \_\_\_\_\_

Më datë: \_\_\_\_\_

### 5.3 [ZK] ZONË KOMERCIALE

Kjo zonë është e planifikuar për shfrytëzim komercial. Zona komerciale ka sipërfaqe totale prej 769 ha, nga e cila 138.8 ha (18%) shtrihet në zonë urbane, ndërsa 630.2 ha apo (82%) jashtë zonës urbane. Zona ofron hapësirë për zhvillim të tregtisë dhe industrisë së lehtë. Në të njëjtën kohë zona do të akomodojë shfrytëzime tjera të cilat janë në shërbim të zonës. Zona komerciale planifikohet të zhvillohet në dy lokacione, një sipërfaqe brenda zonës urbane në qytet, dhe sipërfaqja tjetër jashtë zonës urbane.

#### 5.3.1 SHFRYTËZIMI I TOKËS

##### Shfrytëzimet e lejuara

- Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije; shërbim i akomodimit të ushqimit (restorant/bare); automekanik; dhe autolarje.
- Industri e lëndës së parë: prodhim i produkteve të tekstilit, drurit, letrës, kimike dhe firave, metaleve, minerale, të gomës dhe plastikës.
- Industri e prodhimeve të lehta: prodhim i pijeve dhe produkteve të duhanit, rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, dhe pajisje elektrike dhe optike.
- Shërbim profesional financiar dhe i informacionit: shërbime bankare.

##### Shfrytëzimet dytësore

Shfrytëzime dytësore konsiderohen si të tilla të gjitha ato shfrytëzime që shërbejnë si plotësim për shfrytëzimin primar të tokës. Shfrytëzime dytësore janë të gjitha shfrytëzimet (ndërtesat apo strukturat teknike) që shërbejnë si funksion mbështetës për shfrytëzimin primar të tokës. Në vijim janë paraqitë shfrytëzimet dytësore në funksion të parcelave me shfrytëzim primar:

- Shfrytëzim primar: industri; shfrytëzim dytësor: kaldaja, depo, dhe trafo të rrymës.

##### Shfrytëzimet e veçanta

- Industri e prodhimeve të lëndës së parë (Shiko kaptinën 6 për kushte zhvillimore për shfrytëzime të veçanta).

##### Shfrytëzime e ndaluara

Ndalohen të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të renditura në listën e shfrytëzimeve të lejuara, dytësore, dhe të veçanta.

#### HARTA 7: HARTA E ZONËS KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE





### 5.3.2 KUSHTET ZHVILLIMORE

Treguesit bazë	Qytet		Pjesë tjera		
	Shërbim tregtar	Industri e lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta	Shërbim tregtar	Shërbim profesional	Industri e lëndës së parë dhe prodhimeve të lehta
Madhësia e parcelës	Min 1000m <sup>2</sup>	Min 500m <sup>2</sup>	Min 500m <sup>2</sup>	Min 500m <sup>2</sup>	Min 1,000m <sup>2</sup> Max 1,500 m <sup>2</sup>
Balli i parcelës	Min 20m'	Min 20m'	Min 15m'	Min 15m'	Min 30m'
Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN)	Vlera bazë 0.5 Max 1.5	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.50 Max 1	Vlerë bazë 0.50 Max 1	Vlera bazë 0.50 Max 1
Etazhiteti	B+P+2 Max 12m'	P + 0 (7.0 m') P + 1 (12 m')	B+P+1 Max 9 m'	B+P+1 Max 9 m'	P + 0 (7.0 m') P + 1 (12 m')
Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim (ISHPKZh)	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%	Max 50%
Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP)	20%	20%	20%	20%	20%
Sipërfaqja nëntokësore e parcelës (SNP)	50%	0%	50%	50%	0%
<i>Rrjetet e vijave</i>					
Vija Ndërtimore (VN)	Min 6m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 6m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët	Min 8m Përveq kur përcaktohet nga ligji për rrugët
Vija Ndërtimore Nëntokësore (VNNt)	Min 6m	Min 6m	Min 8m	Min 8m	Min 8m
Distanca anësore nga parcela – me hapje primare	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës	Min 0.25H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – me hapje sekondare	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës	Min 0.10H e ndërtesës
Distanca anësore nga parcela – pa asnjë lloj hapje	Ndërtesa mund të ndërtohet deri në kufi të parcelës me kusht që pronarët e parcelave fqinje arrijnë marrëveshje të ndërsjellë të vërtetuar nga Noteri.				
<p>1: Gjerësia minimale e ballit të parcelës varet nga madhësia e parcelës. Gjerësia minimale e ballit të parcelës rritet proporcionalisht me rritjen e madhësisë së parcelës. Rritja e gjerësisë fillon nga vlera bazë e ballit të parcelës të paraqitur në shtyllën përkatëse për cdo shfrytëzim të lejuar. Për cdo rritje të madhësisë së parcelës nga 0 - 100m<sup>2</sup>, gjerësia minimale e ballit të parcelës duhet të rritet për 2.0m', p.sh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 500m<sup>2</sup> – 600m<sup>2</sup> = 20.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës – vlera bazë);</li> <li>• Industri e lëndës së parë: madhësia e parcelës 601m<sup>2</sup> – 700m<sup>2</sup> = 22.0m' (gjerësia minimale e ballit të parcelës).</li> </ul> <p>Kjo rregull vlenë për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të lejuara në këtë zonë.</p>					

### 5.4 [ZBJ] ZONË BUJQËSORE

Sipas Ligjit Nr.02/L-26 për tokën bujqësore: "Toka bujqësore është toka e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdhja peshku dhe moçale,



## 6 KUSHTET ZHVILLIMORE PËR SHFRYTËZIMET E VEÇANTA

Kushtet zhvillimore për shfrytëzimet e veçanta vlejné për të gjitha zonat e listuara më lartë. Të gjitha shfrytëzimet e listuara si të veçanta në të gjitha zonat duhet t'i përmbushin kushtet zhvillimore shtesë si më poshtë. Vetëm pasi që aplikuesi dëshmon që të gjitha kushtet zhvillimore shtesë janë përmbushur, do të jetë në gjendje që të vazhdojë me procedurat tjera për shfrytëzim të parcelës.

<b>Shfrytëzim i vecantë: Shërbim tregtar – kafeteri</b>
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"><li>• E tërë veprimtaria e shërbimit tregtar duhet të zhvillohet brenda kufirit të parcelës. Asnjë tavolinë e kafeterisë nuk do të lejohet të vendoset në pronë publike/komunale pa leje përkatëse;</li><li>• Zhurma e gjeneruar nga zhvillimi nuk do të shkaktoj ndotje akustike për banoret përreth. Lokali duhet të posedoj izolim të përshtatshëm kundër zhurmës dhe të respektoj orarin e punës sipas rregullores komunale.</li></ul>
<b>Shfrytëzim i vecantë: Shërbim tregtar: hapësira për shitje me shumicë të mallrave shtëpiake, tekstile, ushqim, dhe pije.</b>
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të gjitha vend parkimet e dedikuara për klientë duhet të vendosen brenda kufirit të parcelës për zhvillim vend parkim për 100m<sup>2</sup>.</li><li>• Ngarkimi/shkarkimi i mallit duhet të behët brenda kufijve të parcelës pa krijuar problem në qarkullim të komunikacionit në rrugët përreth parcelës.</li></ul>
<b>Shfrytëzim i vecantë: Automekanik</b>
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Të gjitha automjetet që janë duke u riparuar dhe ato që janë në pritje për riparim duhet të parkohen brenda kufijve të parcelës për zhvillim – 2 vend parkime për 100m<sup>2</sup>;</li><li>• Hyrja dhe dalja në parcelë/objekt duhet të jetë lehtë e qasshme dhe e sigurt për qarkullim;</li><li>• Të gjitha punët mekanike që shkaktojnë zhurmë duhet të zhvillohen brenda objektit me izolim të përshtatshëm kundër zhurmës;</li><li>• Kompresorët e ajrit dhe të gjitha mjetet tjera që shkaktojnë zhurmë duhet të vendosen brenda objektit;</li><li>• Të gjitha llojet e fraksioneve të mbeturinave: vaj motori, bateri etj., duhet të deponohen në hapësira të veçanta brenda kufirit të parcelës deri në mbledhjen e tyre nga kompanitë e licencuara për grumbullim të mbeturinave.</li></ul>
<b>Shfrytëzim i vecantë: Autolarje</b>
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Autolarjet nuk do të kenë qasje në rrjetin e ujësjellësit lokal. Shfrytëzimi i ujit për larje të automjeteve duhet të jetë burimi i ujit nga bunarët lokal apo nga burimet tjera të ujit përveç të rrjetit të ujësjellësit lokal.</li><li>• Autolarjet nuk mund të vendosen në afërsi të rrathëve rrotullues. Ato do të lejohen në largësi prej 100m gjatësi afër rrathëve rrotullues.</li><li>• Hyrjet dhe daljet në objekt duhet të jetë qarta, lehtë të qasshme dhe të sigurta për qarkullim.</li><li>• Automjetet e pastruara dhe ato që presin të pastrohen duhet të parkohen brenda kufijve të parcelës. Nuk lejohet parkimi i automjeteve të pastruara dhe atyre që presin të pastrohen në</li></ul>

trotuare/rrugë përreth parcelës për zhvillim duke krijuar problem në qarkullim të komunikacionit dhe këmbësorëve – 2 vend parkime për një kompresor të ujit.
Shfrytëzim i vecantë: Parkingje private
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parcela për zhvillim duhet të ketë qasje në rrugë kryesore me ballë të parcelës minimum 10m.</li> </ul>
Shfrytëzim i vecantë: Saldues (farkëtar)
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjitha punët mekanike që shkaktojnë zhurmë duhet të zhvillohen brenda objektit me izolim të përshtatshëm kundër zhurmës.</li> <li>• Automjetet dhe strukturat për riparim duhet të parkohen/vendosen brenda kufijve të parcelës për zhvillim.</li> </ul>
Shfrytëzim i vecantë: Pompë të karburanteve
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndalohet ndërtimi në distancë më të vogël se 1,000 m nga kufiri i parcelave për banim.</li> </ul>
Industri e prodhimeve të lëndës së parë
Kushte zhvillimore shtesë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzimi për industri të prodhimeve të lëndës së parë duhet të siguroj që nuk do të shkaktoj ndotje, zhurmë, dhe shqetësime tjera për shfrytëzimet primare të zonës. Masat mbrojtëse dhe parandaluese duhet të sigurohen nga aplikuesi para së të lëshohet miratohet shfrytëzimi përkatës.</li> </ul>









## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409036-00164-20

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:  
Komuna / Opština / Municipality:  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

165/2025  
14.01.2025 - 10:21  
LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN  
Konjuh / Konjuh / Konjuh  
LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71409036-00164-20	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	/ /	17643			

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
BRANJESH				



## A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Poljoprovredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land	17643

## B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Peshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1	AK.NR.1666/2024 VENDIMI PER ANULLIM PJESERISHEM TE VENDIMIT 1.464.164 TE DT.01.08.2006 PER SHFRYZIMIN AFATGJATE ME NR.15 NR.464.11834 TE DT.04.03.2016 KUVENDI I KOMUNES LIPJA	19.08.2024



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409036-00166-7

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

165/2025  
14.01.2025 - 10:20

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIJAN

Konjuh / Konjuh / Konjuh

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIJAN

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta inovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71409036-00166-7	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /		12357			

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
BRANESH				





## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Nëmbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Pojiprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land	12357

## B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postaral Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosť adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	/ / /		SHQIPËRIA	1/1	AK.NR.1666/2024 VENDIMI PER ANULLIM PËSEBISHEM TE VENDIMIT 1.464-164 TE DT.01.08.2006 PER SHFRYZIMIN AFATGJATE ME NR.15 NR.464-11834 TE DT.04.03.2016 KUVENDI I KOMUNES LIPJA	19.08.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Konjuh

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71409036-00166-7	Parcelë / Parcela / Parcel	12357
P-71409036-00164-20	Parcelë / Parcela / Parcel	17643



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1309

Punoi/Obradio/Created: Izjah Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.01.2025

Koha/ Vreme/ Time: 03:34:21

